

Shoqata Aksionare për Menaxhim me Hapësirë Afariste në Pronësi të Shtetit - Shkup

LAJMËRIM për korrigjim të Shpalljes 1

Në bazë të Shpalljes numër 1 për shitja të hapësirës afariste në pronësi të Republikës së Maqedonisë nëpërmjet ankandit publik elektronik, e shpallur më 12.02.2015 (të enjte), Shoqata Aksionare e informon publikun se nga lista e shitjes është tërhequr hapësira afariste në vijim:

1. Për objektin afarist të dhënë në pasqyrimin tabelar në **numrin rendor 3 në tabelën për qytetin e Manastirit (hapësirë afariste nr.25)** është e nevojshme që ofertdhënësi më i përshtatshëm (pronari i ardhshëm) **ta mbajë aktivitetin e objektit afarist - librari (bibliotekë) në periudhë prej minimum 10 vjetësh nga momenti i solemnizimit të marrëveshjes për shitje të objektit afarist.**

Nëse ofertdhënësi më i përshtatshëm (pronari i ardhshëm) nuk e mban aktivitetin ekzistues të objektit afarist - librari në periudhë prej minimum 10 (dhjetë) vjet nga momenti i solemnizimit në Marrëveshjen për shitje të objektit afarist, Republika e Maqedonisë si shitës ka të drejtë të kërkojë prishje të Marrëveshjes për shitje të objektit afarist në pronësi të Republikës së Maqedonisë dhe gjatë kësaj mjetet e paguara në përputhje me çmimin e fundit të arritur në ankand nuk i kthehen ofertdhënësit më të përshtatshëm.

Ky obligim është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për shitje të objektit afarist të dhënë në pasqyrën tabelare me numër rendor 3 në tabelën për qytetin e Manastirit nr. 25).

2. Fotografia e vendosur tek objekti afarist në pasqyrimin tabelar me **numër rendor 5 në tabelën për qytetin e Manastirit (objekti afarist nr. 27) e tregon objektin e dhënë nën numrin rendor 6 në tabelën për qytetin e Manastirit, (objekti afarist nr. 28),** kurse fotografia e vendosur tek objekti afarist të dhënë në pasqyrimin tabelar në **numrin rendor numër 6 në tabelën për qytetin e Manastirit (objekti afarist nr. 28) e tregon objektin e dhënë në numrin rendor 5 në tabelën për qytetin e Manastirit (hapësirë afariste nr. 27).** Të gjitha të dhënat tek të dy objektet mbeten të pandryshuara.
3. Për shkak të mospërputhjes së të dhënave të vendosura në Shpalljen numër 1 dhe të dhënave reale për objektin afarist, **nga lista e shitjes tërhiqet objekti që vijon:**

II. Manastir, numri rendor 7, në PK 2899, PK Manastir 4, IL 93903, Rr. Prilepska nr.7/4, kati përdhes, lokali nr.1, me sipërfaqe prej 62 m² dhe me vlerë tregu prej 3.370.135,00 denarësh.

**Shoqata Aksionare për Menaxhim me
Hapësirë Afariste në Pronësi të Shtetit - Shkup**